



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.11**

**18 shkurt**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.51, datë 26.1.2011	Për një shtesë fondi Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile, për përballimin e situatës emergjente të krijuar në qarkun e Shkodrës, si pasojë e përmbajtjeve natyrore.....	257
Vendim i KM nr.67, datë 2.2.2011	Për miratimin, në parim, të protokollit që ndryshon aneksin e sigurisë së marrëveshjes, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik.....	257
Vendim i KM nr.73, datë 2.2.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.303, datë 25.3.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, të ndryshuar.....	259
Vendim i KM nr.74, datë 2.2.2011	Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil.....	261
Vendim i KM nr.75, datë 2.2.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By pass Plepa – Kavajë - Rrogozhinë, lotet 6 e 7”.....	263
Vendim i KM nr.76, datë 2.2.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.781, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kv, Tiranë – Podgoricë, qarku Durrës”.....	265

Vendim i KM nr.77, datë 2.2.2011	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të pronës nr.272, me emërtim “Depo të repartit ushtarak nr.8833”, në Pisha Krastë, Elbasan, të pronës nr.280, me emërtim “Reparti ushtarak nr.5012/38”, në Krastë, Elbasan, dhe të disa mjediseve e të truallit funksional, me sipërfaqe 176869.75 m <sup>2</sup> , pjesë e pronës nr.271, me emërtim “Shtabi i repartit ushtarak nr.8833”, në Krastë, Elbasan, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	266
Vendim i KM nr.78, datë 2.2.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.786, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, “Master i Shkencave”, për vitin akademik 2010 - 2011”, të ndryshuar.....	273
Vendim i KM nr.94, datë 9.2.2011	Për përcaktimin e masës së shpenzimeve të zbritshme për mjekim, për vete apo për fëmijët e personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, e për deklaratën personale të të ardhurave.....	278
Vendim i ERE nr.5, datë 2.2.2011	Për licencimin e shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	278
Vendim i ERE nr.6, datë 2.2.2011	Për licencimin e shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	279
Vendim i ERE nr.7, datë 2.2.2011	Për licencimin e shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	280
Vendim i ERE nr.8, datë 2.2.2011	Për licencimin e shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	281
Vendim i KKRT nr.19, datë 21.1.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Skampa”.....	282
Vendim i KKRT nr.20, datë 21.1.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Lezha”.....	282
Vendim i KKRT nr.21, datë 21.1.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Onufri”.....	283
Vendim i KKRT nr.22, datë 21.1.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio +3”.....	283
Vendim i KKRT nr.23, datë 21.1.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Klea”.....	284
Vendim i KKRT nr.24, datë 21.1.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Puka”.....	284
Vendim i KKRT nr.48, datë 21.1.2011	Për reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës së televizionit privat vendor “Tele 1”.....	285

**VENDIM**  
**Nr.51, datë 26.1.2011**

**PËR NJË SHITESË FONDI KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCAVE CIVILE, PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EMERGJENTE TË KRIJUAR NË QARKUN E SHKODRËS, SI PASOJË E PËRMBYTJEVE NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, si dhe të nenit 31 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Brendshme, në fondin financiar, programi “Emergjenca civile”, t’i shtohet fondi prej 295 029 876 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, i ndarë, si më poshtë vijon:

a) 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekë, për blerjen e bazës ushqimore (koncentrat dhe bar i thatë), për periudhën janar-mars 2011.

b) 25 029 876 (njëzet e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, për kryerjen e punimeve emergjente në disa objekte (argjinatura) për mbrojtjen nga përmbytjet.

2. Fondi prej 295 029 876 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh të përballohet nga KESH sh.a. (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare).

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Brendshëm dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.67, datë 2.2.2011**

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT QË NDRYSHON ANEKSIN E SIGURISË SË MARRËVESHJES, NDËRMJET PALËVE TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR, PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin, në parim, të protokollit që ndryshon aneksin e sigurisë së marrëveshjes, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, bërë në Bruksel, më 2 qershor 1998.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**PROTOKOLL**  
**QË NDRYSHON ANEKSIN E SIGURISË SË MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE TË**  
**TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME**  
**INFORMACIONIN ATOMIK,**

*Duke pasur parasysh* që zhvillimet në sigurinë e informacionit atomik kërkojnë rishikimin e shpeshësisë së inspektimit të plotë të sigurisë të të gjitha elementeve ushtarake dhe civile të NATO-s dhe të shteteve anëtare që kanë marrë informacion në bazë të Marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, palët e poshtëshënuara kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Aneksi i sigurisë së marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, bërë në Paris më 18 qershor 1964, ndryshohet sipas parashikimit në nenin 2.

Neni 2

Fjalja e parë e seksionit X, inspektimet e sigurisë, paragrafi A, e aneksit të sigurisë së marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, zëvendësohet me fjalinë e mëposhtme:

“A. Inspektimi i plotë i sigurisë të të gjitha elementeve ushtarake dhe civile të NATO-s dhe shteteve anëtare që kanë marrë informacion atomik sipas marrëveshjes kryhet rregullisht, gjatë një periudhe që përcaktohet nga Këshilli i Atlantikut Verior, në bazë të rekomandimit të Komitetit të Sigurisë së NATO-s, me kriteret e parashikuara në seksionin I, paragrafi A i këtij aneksi.”.

Neni 3

Ky protokoll hyn në fuqi me marrjen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të njoftimit nga të gjitha shtetet palë në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, që ata kanë vullnetin t’u nënshtrohen termave të këtij protokoll.

Neni 4

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon të gjitha palët dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior për çdo njoftim dhe për hyrjen në fuqi të këtij protokoll.

Neni 5

Ky protokoll mban datën në të cilën është hapur për nënshkrim dhe mbetet i hapur për nënshkrim derisa të nënshkruhet nga të gjitha palët në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për Bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Bruksel, më 2 qershor 1998, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëjloj autentike, në një kopje origjinale të vetme që depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila u transmeton kopje të certifikuara të saj të gjitha shteteve nënshkruese dhe aderuese.

**VENDIM**  
**Nr.73, datë 2.2.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.303, DATË 25.3.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 76 të ligjit nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në tekstin e rregullores së përgjithshme të burgjeve, miratuar me vendimin nr.303, datë 25.3.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i pjesës së parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Dispozita të përgjithshme”.

2. Pas pikës 3 të nenit 2, shtohen pikat 4, 5 e 6, me këtë përmbajtje:

“4. “Të dhëna personale” është çdo informacion për të burgosurit, vendas ose të huaj, si dhe për personelin, të cilët janë të identifikuar ose të identifikueshëm. Elementet, me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë apo kulturorë.

5. “Të dhëna sensitive” është çdo informacion për të burgosurit dhe personelin, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

6. “Kontrollues” është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, të cilat vetëm ose në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhënat personale.”.

3. Pas pikës 1 të nenit 13, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Personat, që, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.”.

4. Pika 2 e nenit 17, riformulohet, si më poshtë vijon:

“2. Në ambientet e brendshme të IEVP-së nuk lejohet të mbahen dhe të qarkullohen nga të burgosurit:

a) Objektet që përbëjnë vepër penale;

b) Sendet që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e të burgosurve dhe të personelit, si dhe sigurinë e institucionit;

c) Pajisje transmetimi dhe komunikimi, përfshirë aparatet celulare dhe fotografike;

ç) Vlera monetare të çdo lloji;

d) Aparate dhe antena digjitale, pas vendosjes nga institucioni të antenave të përbashkëta;

dh) Pajisje të njëjta me ato që ofrohen nga institucioni, të cilat janë pjesë e dhomës apo e mjediseve të përbashkëta;

e) Pishtarë, qirinj, llamba vaji, pajisje filmi dhe video;

ë) Sende me karakter diskriminues, provokues apo ushtarak;

f) Bizhuteri, përveç atyre të lejuara sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme të institucionit;

g) Më shumë se 1 (një) televizor dhe frigorifer për çdo dhomë.”.

5. Në fund të pikës 2 të nenit 32 shtohen fjalët “... dhe përmban të dhëna personale e sensitive ...”.

6. Pas shkronjës “b” të nenit 41 shtohet shkronja “b/1”, me këtë përmbajtje:

“b/1) U garantohet mbrojtja, ruajtja dhe siguria e të dhënave personale;”.

7. Shkronja “ë” e nenit 42 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) të respektojnë dinjitetin dhe privatësinë e të burgosurve të tjerë, si dhe të personelit të IEVP-së;”.

8. Në pikën 4 të nenit 52 pas fjalëve “... personeli i shëndetësisë ...” shtohen fjalët “... personeli i sektorit ligjor ...”.

9. Në fund të pikës 1 të nenit 60 shtohen fjalët “... dhe t’i garantohet fshehtësia e saj ...”.

10. Pas kreut V të pjesës së tretë, shtohet kreu V/1, me këtë përmbajtje:

## “KREU V/1 TË DHËNAT PERSONALE

Neni 62/1

### **Mbrojtja e të dhënave personale të të burgosurve**

I gjithë personeli i IEVP-së përpunon të dhënat personale të të burgosurve në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 62/2

### **Masat për sigurinë e të dhënave**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe drejtori i IEVP-së marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Përpunimi i të dhënave brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-ve duhet të jetë rreptësisht i kontrolluar. Sipas standardeve të larta të sigurisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe drejtori i IEVP-së, respektivisht, merr këto masa të veçanta sigurie:

a) Përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe specialistëve për përdorimin/përpunimin e të dhënave;

b) Përdorimi/përpunimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të specialistëve të autorizuar;

c) Ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;

ç) Hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar;

d) Ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;

dh) Vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;

e) Regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet apo çdo formë tjetër përpunimi.

3. Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe të drejtorit të IEVP-së përcaktohen njësia organizative dhe specialistët e autorizuar për përpunimin e të dhënave personale, respektivisht, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në IEVP.

Neni 62/3

### **Zbatimi i rregullave të sigurisë së të dhënave personale**

1. Personeli i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-së zbatojnë me korrektësi legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe vendimet apo udhëzimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim arritjen e një niveli sigurie të përshtatshëm gjatë përpunimit të të dhënave personale të të burgosurve, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të punës.

2. Veprimi apo mosveprimi, në kundërshtim me këtë dispozitë, përbën shkelje disiplinore dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës së personelit.”.

11. Në nenin 70, shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Përgjegjësi i sektorit të sigurisë, përgjegjësi i sektorit ligjor dhe përgjegjësi i kujdesit social përgatitin brenda ditës nga dita e marrjes së urdhrorit, një raport të përbashkët të hollësishëm, i cili shpjegon dhe dokumenton lidhjen e ngushtë familjare të të burgosurit me personin e sëmurë rëndë, të vdekur, të lindur ose të martuar, kohëzgjatjen e vuajtjes së dënimit, lejet e kryera më parë, respektimin e kësaj rregulloreje dhe rregullores së brendshme të IEVP-së, rrezikshmërinë dhe besueshmërinë që paraqet i burgosuri lidhur me qëndrimin e tij jashtë institucionit, pjesëmarrjen në programe rehabilituese që zhvillohen në institucion, çdo të dhënë tjetër që ka të bëjë me të burgosurin, si dhe propozimin e argumentuar të miratimit apo refuzimit të lejes së veçantë dhe të ditëve që i burgosuri duhet të marrë si leje e veçantë.”.

12. Pas shkronjës “e” të paragrafit 2 të nenit 92 shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) Bashkëpunon me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për përgatitjen e Kodit Etik për mbrojtjen e të dhënave personale në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në të gjitha IEVP-të, si dhe merr masat për ndjekjen e zbatimit të tij.”.

13. Pas pikës 1 të nenit 95 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Procedurat e punësimit të të burgosurve vihen në zbatim menjëherë pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të strukturës organike të punës së të burgosurve, si dhe pas miratimit të buxhetit për shpërbimin e punës për të burgosurit.”.

II. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.74, datë 2.2.2011**

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR TË SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4 e 5 të nenit 106 të ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Komitetit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, me qëllim bashkërendimin dhe zbatimin e masave të sigurisë në aviacionin civil.

2. Ky komitet të kryesohet nga drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil dhe në përbërje të ketë:

- |  |                  |
|--|------------------|
| - drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit                | zëvendëskryetar; |
| - drejtorin e Përgjithshëm të Doganave                           | anëtar;          |
| - drejtorin e Kufirit, në Policinë e Shtetit                     | anëtar;          |
| - drejtorin e Përgjithshëm të Aeroportit                         | anëtar;          |
| - një përfaqësues të operatorëve të shoqërive ajrore             | anëtar;          |
| - drejtorin e Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror (ANTA)       | anëtar;          |
| - drejtorin e Aeroporteve dhe Sigurisë së Aviacionit Civil (AAC) | anëtar;          |
| - komandantin e Forcave Ajrore                                   | anëtar;          |
| - drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile (MB)           | anëtar;          |
| - shefin e Shërbimit të Kërkim - Shpëtimit (SAR/MM)              | anëtar;          |
| - drejtorin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKSHI/MITIK) | anëtar.          |

Sekretari i Komitetit, jurist, anëtar teknik pa të drejtë vote.

3. Komiteti Kombëtar i Sigurisë së Aviacionit Civil, me qëllim bashkërendimin e masave në aviacionin civil, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Këshillon autoritetin përgjegjës për sigurinë në aviacionin civil lidhur me masat e nevojshme ndaj kërcënimeve kundrejt këtij aviacioni dhe subjekteve të tij.

b) Zhvillon dhe zbaton masat e sigurisë në bazë të një rishikimi konstant dhe rekomandimeve për ndryshim të masave të sigurisë, sipas informacioneve për kërcënime dhe akte të jashtëligjshme ndaj aviacionit civil, bazuar në teknikat e reja të sigurisë në aviacionin civil, dhe faktorëve të tjerë.

c) Siguron bashkërendimin ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për aspekte të ndryshme të sigurisë në aviacionin civil, lidhur me zbatimin e Programit Kombëtar të Sigurisë, në varësi të llojit të kërcënimit.

ç) Jep mendim për aspekte të sigurisë, gjatë procesit të projektimit të aeroporteve të reja apo gjatë zgjerimit të atyre ekzistues.

d) Mbikëqyr zbatimin e standardeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare, në përputhje me aneksin 17 (Siguria), dokumentin 8973 (Manuali i sigurisë), të ICAO-s, Dokumentin 30 të Konferencës Europiane të Aviacionit Civil (ECAC), rregulloret e Komisionit Europian për sigurinë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

dh) Harton listën e pikave të dobëta të zonave të kufizuara të sigurisë dhe kryen përditësimin dhe rishikimin e kësaj liste.

e) Organizon vëzhgimin e sigurisë në aeroporte në mënyrë periodike.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil, në çdo rast, paraprakisht, i njofton zyrtarisht Komitetit variantet në fuqi të aneksit 17, të ICAO-s, dokumentit 30 të ECAC -së, rregulloret e Komisionit Europian për sigurinë apo të dokumenteve të tjera ndërkombëtare.

5. Në mbledhjet e Komitetit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil ftohen të marrin pjesë si anëtarë këshillues, pa të drejtë vote, përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, që merren me çështje të administrimit të kufirit, misioni i asistencës doganore për Shqipërinë, si dhe misioni i asistencës policore të Bashkimit Europian për Shqipërinë.

6. Në mbledhjet e Komitetit ftohen dhe përfaqësues të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në aeroporte. Në të gjitha rastet, është i detyrueshëm identifikimi i personave që do të marrin pjesë në mbledhje.

7. Komiteti Kombëtar i Sigurisë së Aviacionit Civil mblidhet rregullisht 4 (katër) herë në vit dhe, në raste të veçanta, me kërkesën e 1/3 të anëtarëve dhe me miratimin e kryetarit e të zëvendëskryetarit të këtij komiteti. Anëtarët këshillues nuk kanë të drejtën e thirrjes së mbledhjes.

8. Data, ora dhe rendi i ditës së mbledhjes u njoftohen, me shkrim, anëtarëve të Komitetit të paktën 10 ditë përpara mbledhjes.

9. Rezultatet e mbledhjes së Komitetit u shpërndahen anëtarëve të tij, me shkrim, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e përfundimit të mbledhjes.

10. Mbledhja e Komitetit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil regjistrohet në audio dhe zbardhet nga sekretaria e këtij Komiteti.

11. Dokumentacioni dhe materialet e përdorura arkivohen.

12. Ngarkohen institucionet e përfshira për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr.75, datë 2.2.2011**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT  
RRUGOR “BY PASS PLEPA – KAVAJË – RROGOZHINË, LOTET 6 E 7”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2010 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By pass Plepa Kavajë – Rrogozhinë, lotet 6 e 7”.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 2810 m<sup>2</sup>, trull dhe arë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 25 598 413 (njëzet e pesë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 592 000 (pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 25 598 413 (njëzet e pesë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekësh të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
6. Shpronësimi të fillojë më 1.2.2011 dhe të përfundojë më 1.5.2011.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
9. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojë procedura e regjistrimit dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja, Kavajë”, pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.
11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, pasi pronarët të kenë përfunduar procedurat e regjistrimit, si dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.
12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kavajë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të vendimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
13. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kavajë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
14. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria

e Përgjithshme e Rrugëve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I BY-PASS  
“PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË” LOTI 6 (TOKAT)

Nr.	Pronari			Zona	Nr. i pas.	Sip. m <sup>2</sup>	Lloji i pasurisë	Çmimi	Vlera	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Mehmet		Dedej	3204	94/2	280	arë	351	98280	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Hatlije		Dedej	3204	94/3	145	arë	351	50895	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Lumturi		Biturku	8551	1/7	158	truall	15000	2370000	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Limane		Kollcaku	8551	1/6	158	truall	15000	2370000	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Rifat		Kollcaku	8551	1/5	154	truall	15000	2310000	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Bashkim		Prrenjasi	8551	1/27	291	truall	15000	4365000	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Arben		Shehi	8551	1/250	264	truall	15000	3960000	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Tahir		Guga	8551	1/253	214	truall	15000	3210000	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Ramazan		Tatani	8551	1/23	13	truall	15000	195000	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Ramazan		Tatani	8551	1/21	127	truall	15000	1905000	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Islam		Dedja	3204	64/14	77	arë	351	27027	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Islam		Dedja	3204	64/23	37	arë	351	12987	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Ali		Tatani	3204	64/24	70	arë	351	24570	Konfirmuar nga ZVRPP
14	B/Pr. Tatani			3204	65/5	31	truall	931	28861	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Xhavit		Beka	3204	65/4	13	truall	931	12103	Konfirmuar nga ZVRPP
	<b>Shuma</b>					<b>2032</b>			<b>20939723</b>	

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I BY-PASS  
“PLEPA-KAVAJË-RROGOZHINË” LOTI 7 (TOKAT)

Nr.	Pronari			Zona	Nr. pas.	Si. m <sup>2</sup>	Lloji i pasurisë	Çmimi	Vlera	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Zyber		Çullhaj	8552	1/153	55	truall	16700	918500	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Agron		Elezi	8552	10/50	9	truall	16700	150300	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Xhavit		Kollcaku	8552	10/232	23	arë	359	8257	Proces regjistrimi
4	Muharrem		Kollcaku	8552	10/60	204	truall	16700	3406800	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Sulejman		Allajbej	8552	12/287	96	arë	359	34464	Proces regjistrimi
6	Sulejman		Allajbej	8552	12/289	84	arë	359	30156	Proces regjistrimi
7	Sulejman		Allajbej	8552	12/290	103	arë	359	36977	Proces regjistrimi
8	Sulejman		Allajbej	8552	12/291	89	arë	359	31951	Proces regjistrimi
9	Sulejman		Allajbej	8552	12/292	65	arë	359	23335	Proces regjistrimi
10	Hasan		Allajbej	8552	12/257	50	arë	359	17950	Proces regjistrimi
	<b>Shuma</b>					<b>778</b>			<b>4658690</b>	

**VENDIM**  
**Nr.76, datë 2.2.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.781, DATË 29.9.2010 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË**  
**PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I**  
**LINJËS 400 KV, TIRANË – PODGORICË, QARKU DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.781, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2159.4 (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë katër) m<sup>2</sup>, tokë bujqësore, shtëpi, arë dhe ullishte, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 11 980 921 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekësh.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi prej 11 980 921 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekësh, të përballohet nga fondet e OST sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**SHTESA E LISTËS SË PRONARËVE PËR SHPRONËSIM PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË**  
**LINJËS SË TENSIONIT TË LARTË 400 KV TIRANË-PODGORICË, QARKU DURRËS**

Qarku: Durrës  
Komuna: Nikël

Nr.	Objekti	Shpronësim definitiv									
		Emri	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr.i pasurisë	Sasia e sipërfaqes së pronës m <sup>2</sup>	Çmimi shitje ZRPP lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e kompensimit	Adresa	Informacion
1	Linja 400kv	Asllan	Zaja	Shtëpi nën linjë	2737	942/6	165.2	36561	6,039,877	Nikël	ALUIZNI
2	Linja 400kv	Refat	Cangu	Shtëpi nën linjë	3783	239/18	103.5	36561	3,784,064	Nikël	Me certifikatë pronësie
									<b>9 823 941</b>		

**VENDIM**  
**Nr.77, datë 2.2.2011**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTERIA E MBROJTJES  
TE MINISTERIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR  
XHUVANI”, ELBASAN, TË PRONËS NR.272, ME EMËRTIM “DEPO TË REPARTIT  
USHTARAK NR.8833”, NË PISHA KRASTË, ELBASAN, TË PRONËS NR.280, ME  
EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR.5012/38”, NË KRASTË, ELBASAN, DHE TË DISA  
MJEDISEVE E TË TRUALLIT FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE 176869.75 M<sup>2</sup>, PJESË E  
PRONËS NR.271, ME EMËRTIM “SHTABI I REPARTIT USHTARAK NR.8833”, NË  
KRASTË, ELBASAN, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË  
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË  
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të pronës nr.272, me emërtim “Depo të repartit ushtarak nr.8833”, në Pisha Krastë, Elbasan, të pronës nr.280, me emërtim “Repartit ushtarak nr.5012/38”, në Krastë, Elbasan, dhe të disa mjediseve e të truallit funksional, me sipërfaqe 176 869.75 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>, pjesë e pronës nr.271, me emërtim “Shtabi i repartit ushtarak nr.8833”, në Krastë, Elbasan, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për t’i përdorur për ndërtimin e kampusit universitar, për ambiente arsimore të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

2. Prona nr.272, me emërtim “Depo të repartit ushtarak nr.8833”, në Pisha Krastë, Elbasan, prona nr.280, me emërtim “Repartit ushtarak nr.5012/38”, në Krastë, Elbasan, dhe disa mjedise e truallit funksional, me sipërfaqe 176 869.75 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>, pjesë e pronës nr.271, me emërtim “Shtabi i repartit ushtarak nr.8833”, në Krastë, Elbasan, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Dorëzimi i mjediseve dhe i truallit funksional të këtyre pronave do të bëhet pas transferimit të Komandës së Mbështetjes Rajonale dhe pas heqjes së materialeve e të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të magazinuara në këto prona.

4. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t’i tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.


5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Zyra Qendrore e Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**PLAN-VENDOSJA**  
**PRONA Nr 271(Shtabi i Rep Usht.8833.) + Prona 280 Rep Usht Nr 5012/38**  
**KRASTA E MADHE ELBASAN**

SISTEMI I KORDINATAVE SHETERORE



SE IDE HEDRIZI NE TEREKALIM BAF. TË NIKARIT QË PËR DASHË...  
 (Small illegible text block)

**S2+S3 SIPERFAQE QE MBETEN NE ADMINISTRIM TE MM**


SIP. QE I MBETET REPARTIT=27495.35m<sup>2</sup>

RIPUNUAR DHJETOR 2010

PUNOI  
 ING. ALBERT MURATI

MAJOR: RAMIZ HAXHIU  
 PERGJ. DEPARTAMENTIT GJEOMATIKES

SHKALLA 1:2500



NGJ. ARMIR ÇANI  
 DREJTOR I.G.J.U

				Muze		193				
				P.hapje nr.1		200				
				P.hapje nr.2		179				
				Blloku banjë wc		120				
				Depo gazermimi		275				
				Garazh		46				
				Oficinë		302				
				Autopark		253				
				Fjetinë klasë		288				
				Mur rrethues		96 ml				Dëmtuar plotësisht
				Rrugë të brendshme		300				Zënë forcërisht
				Truall		18482				Zënë forcërisht
271			<b>Shtabi i repartit ushtarak 8833</b>			<b>308808 m<sup>2</sup></b>	<b>Për mbrojtjen</b>	<b>MM repartit ushtarak 8800 Tiranë</b>	<b>Repartit nr.8833 Tiranë</b>	
			Krastë, L."Koferenca e Labinotit", Elbasan	Truprojë	Elbasan	26				
				Banjë dush		79				
				WC		18				
				Zyra komande		1839				2 kate
				Mensë, kuzhinë, klub		115				
				Depo ndërlidhjeje		61				
				Depo materialesh		100				
				Park		1035				
				Mensë, kuzhinë, ish-BrT		256				
				Trup roje		45				
				Zyra, fjetinë, klasa		642				2 kate
				Depo materialesh		138				Dëmtuar plotësisht
				Zdrukthëtari		48				"
				Truprojë e vjetër		157				
				Banjë dush		20				
				Kabinë elektrike		12				2 kate
				Banjë wc		12				
				Mensë kuzhinë		192				
				Truprojë (depo)		144				
				Lavanteri depo		216				
				Depo kimie, xhenio		216				
				Depo P.hapje		110				
				Park dhe depo		684				

			WC	16				
			Zyra shtabi ish-BrT	100				Dëmtuar plotësisht
			Klub	32				
			Duarlarëse	18				
			Depo armatimi	1320				
			Poligon qitje tanku	630				
			Oficinë ish-BrT	270				
			Park	270				
			Park	540				
			Depo teknike	24				
			Depo ish-central	16				
			Laborator baterish	40				
			Depo materialesh	45				
			Depo	20				
			Laborator baterish	20				
			Pikë karburanti	9				
			Ish depo e B.F	600				
			Ish depo e B.F	600				
			Tunel nr.1 kimie	200				
			Tunel nr.2 kimie	200				
			Tunel nr.3 kimie	200				
			Tunel nr.4 A.K.A	200				
			Tunel nr.5 armatimi	320				
			Tunel nr.6 armatimi	320				
			Tunel nr.7 armatimi	320				
			Tunel nr.8 tankesh	320				
			Tunel nr.9 tankesh	320				
			Tunel nr.10 tankesh	320				
			Tunel nr.11 tankesh	320				
			Tunel nr.12	320				
			Tunel nr.13	320				
			Tunel nr.14	320				
			Tunel nr.15	320				
			Tunel nr.16	300				
			Tunel nr.17	320				
			Tunel nr.18	320				
			Tunel nr.19	320				
			Tunel nr.20 tankesh	320				
			Tunel nr.21 tankesh	320				
			Tunel nr.22 municion	320				

				Tunel nr.23 municion		320				
				Tunel nr.24 karbur		300				
				Kënd sportive		7500				
				Rrugë të brendshme		11250				
				Rrjet elektrik		2000 ml				
				Rrjet ujësjellësi		1500 ml				
				Rrjet kanalizimi		600 ml				
				Truall		279323				
272			<b>Depo të repartit 8833</b>			<b>10400 m<sup>2</sup></b>	<b>Për mbrojtjen</b>	<b>MM reparti ushtarak 8800 Tiranë</b>	<b>Reparti nr.8833 Tiranë</b>	
			Pisha Krastë, Elbasan	Zyra	Pisha Krastë, Elbasan	36				
				Depo P.hapje nr.1		196				
				Depo P.hapje nr.2		196				
				Depo P.hapje nr.3		196				
				Depo ish-truproja		40				
				P.hapje V.K.Br.Xh		80				Dëmtuar plotësisht
				Tunel ish-V.K.Br.Xh		120				
				Tunel depo karburan		200				
				Rrugë të brendshme		2100				
				Rrjet elektrik		220 ml				
				Truall		7556				
273			<b>Ish-batalioni AKA</b>			<b>28176 m<sup>2</sup></b>	<b>Për mbrojtjen</b>	<b>MM reparti ushtarak 8800 Tiranë</b>	<b>Reparti nr.8833 Tiranë</b>	
			Parku Krastë "Konferenca e Labinotit", Elbasan	Vend kontrolli teknik	Elbasan	16				
				Autopark 16-vendesh		270				
				Autopark 9-vendesh		366				
				Depo mat.xheniere		96				
				Depo e materialeve		120				
				Autopark 10 vende		630				
				WC		12				
				P.hapje nr.1		64				
				P.hapje nr.2		40				
				P.hapje nr.3		40				
				Zyra ish-truproje		36				
				Kovaçhana		21				Dëmtuar plotësisht
				Ish-zdrukthëtari		144				"



				Rrugë të brendshme		450				
				Rrjet elektrik		240 ml				
				Rrjet ujësjellësi		650 ml				
				Truall		25871				
<b>274</b>			<b>Ish-reparti ushtarak nr.2410</b>			<b>18200 m<sup>2</sup></b>	<b>Për mbrojtjen</b>	<b>MM reparti ushtarak 8800 Tiranë</b>	<b>Reparti nr.8830 Tiranë</b>	
			N.SH.U Zaranik L. "28 Nëntori" Elbasan	Depo kimie	Elbasan	71				Proces privatizimi
				Banjë e vjetër		72				"
				Depo kimie		36				"
				Autopark		68				Proces privatizimi

			<b>Nr.5012/38</b>			<b>M<sup>2</sup></b>		<b>Tiranë</b>	<b>Elbasan</b>	
			Shkumbin, Elbasan	Depo materiale	Shkumbin, Elbasan	360				
				Depo materiale		192				Dëmtuar
				Depo materiale		192				Dëmtuar
				Depo materiale		252				Dëmtuar
				Depo materiale		378				Dëmtuar
				Park		378				
				Park		378				
				Park		378				
				Park		378				
				Park		378				
				Park		378				
				Truprojë		50				
				Banjë WC		4				Dëmtuar
				Zyrë of.rojës		16				
				Kapanon i hapur		150				Dëmtuar
				Vend-rojë		4				
				Rrethim me tel		700 ml				
				Truall		31134				
<b>280</b>			<b>Repart i ushtarak nr.5012/38</b>			<b>1512 M<sup>2</sup></b>	<b>Për mbrojtjen</b>	<b>MM repart i ushtarak 5010 Tiranë</b>	<b>Repart i ushtarak nr.5012 Elbasan</b>	
			Krastë, Elbasan	Depo materiale	Krastë, Elbasan	756				Dëmtuar
				Depo materiale		756				Dëmtuar
<b>281</b>			<b>Ish-Repart i nr.3081 (9856 dhe 9856/3)</b>			<b>29500 m<sup>2</sup></b>	<b>Për mbrojtjen</b>	<b>MM repart i 3400 Tiranë</b>	<b>Repart i ushtarak nr.3400 Tiranë</b>	
			Fushë Mbret Elbasan	Zyrat e komandës	Elbasan Fushë-Mbret	192				2 kate shkatërruar zënë forcërisht
				Truprojë		49				“
				Pikë hapjeje		81				“
				Kuzhinë mensë, p/hapje		192				2 kate zënë forcërisht

**VENDIM**  
**Nr.78, datë 2.2.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.786, DATË 29.9.2010 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË  
STUDIMEVE, “MASTER I SHKENCAVE”, PËR VITIN AKADEMIK 2010 - 2011”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr.786, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2010 - 2011, të jenë 6715. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- |   |       |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave” | 6525; |
| b) Kuotat për programe të dyta studimi                                      | 0;    |
| c) Kuotat për transferimin e studimeve                                      | 100;  |
| ç) Kuotat për të huajt  | 50;   |
| d) Kuotat për të verbrit  | 20;   |
| dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët                                   | 20.”. |

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

- a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, për aplikantët brenda territorit të vendit, 5873;
- b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, për aplikantët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit 652.”.

3. Tabelat nr.1/1 dhe nr.2/1, që i bashkëlidhen vendimit në fuqi, zëvendësohen me tabelat nr.1/1 dhe nr. 2/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Tabela nr.1/1

## TABELA E KUOTAVE “MASTER I SHKENCAVE”, 2010-2011

		UT	UPT	UBT	UE	USH	UK	UGJ	UV	UD	UST	QSA	AKMB	Shuma
Nr.	Emërtimet e programeve të studimit	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	
1	Biologji mjedisore	15				30								45
2	Biologji molekulare	30												30
3	Fizikë	20							40					60
4	Bioteknologji	25												25
5	Kimia industriale dhe mjedisore	40												40
6	Inxhinieria e proceseve kimike	40												40
7	Shkencat dhe teknologjitë ushqimore	40												40
8	Kimi	45												45
9	Matematikë	45												45
10	Matematikë dhe financë								120					120
11	Mësues në AM në biologji	60												60
12	Mësues në AM në kimi	50												50
13	Mësues në AM në fizikë	50												50
14	Mësues në shkencë sociale	50												50
15	Mësues për gjuhën angleze	30												30
16	Mësues në AM në matematikë	80												80
17	Edukim special								40					40
18	Inxhinieri matematike dhe informatike	45												45
19	Informatikë	50												50
20	Gjuhë dhe komunikim ndërkulturore turistik	130												130
21	Përkth. teknik-letërar dhe interpretim	130												130
22	Gjuhësi	125			21									146
23	Letërsi	113												113
24	Histori	37												37
25	Mësuesi gjuhë angleze	150												150
26	Mësuesi gjuhë italiane	80												80
27	Mësuesi gjuhë frënge	60												60
28	Mësuesi gjuhë gjermane	60												60
29	Gjeografi	62												62
30	Arkeologji	19												19
31	Trashëgimi kulturore	19			30									49
32	Marrëdhënie ndërkombëtare	35												35
33	Gazetari	100												100
34	Përkatësi gjinore dhe zhvillim	105												105
35	Psikolog edukimi				60									60
36	Psikolog shkollor/organizacional	60												60
37	Psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdh.	60												60
38	Filozofi sociale	85					40							125
39	Mësuesi në Fakultetin e Shkencave	10												10

	Sociale													
40	Teori politike	67												67
41	Sociologji e zhvillimeve shoqërore	73												73
42	Punë sociale	125												125
43	Menaxhim infermieror	220												220
44	Teknikë laborator	70												70
45	Fizioterapi	80												80
46	Mami	55												55
47	Imazheri	70												70
48	Shëndet publik	48												48
49	Inxhinieri elektronike		25											25
50	Inxhinieri e telekomunikacionit		25											25
51	Inxhinieri informatike		25											25
52	Inxhinieri elektrike													
53	Inxhinieri elektrike (Energjetikë, Aut i industrisë)		60											60
54	Inxhinieri mekanike		70											70
55	Inxhinieri materiale		30											30
56	Inxhinieri tekstili dhe mode		30											30
57	Inxhinieri gjeologjike		60											60
58	Inxhinieri e burimeve natyrore		40											40
59	Inxhinieri gjeofizike		15											15
60	Inxhinieri gjeomjedisi		20											20
61	Inxhinieri mjedisi		65											65
62	Inxhinieri ndërtimi		165											165
63	Inxhinieri hidroteknikë		35											35
64	Inxhinieri gjeodezi		45											45
65	Inxhinieri agrare (Hortik. Mbroj.Bim. Zootek.Akuak.)			130										130
66	Inxhinieri agromjedisi (agromjedis dhe ekologji)			50										50
67	Inxhinieri agroushqimore			50										50
68	Vreshtari-enologji			20										20
69	Inxhinieri përpunim druri			30										30
70	Inxhinieri pyjore			30										30
71	Ekonomi dhe politika agrare			90										90
72	Financë-kontabilitet			100										100
73	Drejtim i ndërmarrjeve			20										20
74	Menaxhim financiar			20										20
75	Financë							70						70
76	Menaxhim agrobiznesi			60										60
77	Inxhinieri matematike		40											40
78	Inxhinieri fizike		40											40
79	Turizëm i qendrueshëm					30								30
80	Mbrojtje mjedisi				30									30
81	Matematikë e zbatuar				25									25
82	Studime të thelluara në gjuhësi					30								30

83	Studime letrare					30								30
84	Studime shqiptare dhe etnokulturore					30								30
85	Ekonomi													
86	Ekonomi biznesi										30			30
87	Menaxhim										30			30
88	Financë bankë										30			30
89	Politika dhe administrim										30			30
90	Marketing										30			30
91	Administrim publik										30			30
92	Master i Shkencave në drejtësi civile	100												100
93	Master i Shkencave në drejtësi penale	100												100
94	Master i Shkencave në drejtësi publike	100												100
95	E drejta private e biznesit					60								60
96	E drejta kushtetuese dhe administrative					60								60
97	Arkeologji dhe Admin. i pasurive arkeologjike							35						35
98	Në fushën financë me përqendrim	90												90
99	Në fushën kontabilitet auditim	30												30
100	Në fushën menaxhim-turizëm	30												30
101	Në fushën marketing	30												30
102	Në fushën sisteme informacioni në ekonomi	30												30
103	Në fushën kërkime operacionale në menaxhim	30												30
104	Në fushën e ekonomiksit	30												30
105	Në fushën administrim biznesi me përqendrim	60												60
106	Në fushën e administrimit publik	30												30
107	Inxhinieri navale								120					120
108	Shkenca kompjuterike								40					40
109	Shkenca kompjutacionale								0					0
110	Shkenca sportive									31				31
111	Master shkencor në Real Estate								70					70
112	Master në fushën e mbrojtjes											65		65
113	Studime gjuhësore										20			20
114	Studime letrare										20			20
115	Studime historike										20			20
116	Studime etnologjike										20			20
117	Studime arkeologjike										15			15
118	Legjislacioni dhe institucionet e BE-së	30												30
119	Politika dhe qeverisja në Europë	30												30
120	Diplomacia dhe Marrëdhëniet ndërkombëtare	30												30
121	Gjuhësi								20					20
122	Letërsi								20					20
	<b>Shuma</b>	<b>3713</b>	<b>790</b>	<b>600</b>	<b>166</b>	<b>270</b>	<b>40</b>	<b>75</b>	<b>500</b>	<b>180</b>	<b>31</b>	<b>95</b>	<b>65</b>	<b>6525</b>

Tabela nr.2/1

**TARIFAT VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT QË DO TË REGJISTROHEN NË  
VITIN E PARË, PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË  
“MASTER I SHKENCAVE”, NË VITIN AKADEMIK 2010-2011**

a) Universiteti i Tiranës:	
I. Fakulteti i Shkencave të Natyrës:	
i) Fizikë	48.000 lekë
ii) Matematikë	48.000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	67.200 lekë
II. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	57.600 lekë
III. Fakulteti Histori-Filologji	
i) Arkeologji	86.400 lekë
ii) Trashëgimi kulturore	86.400 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	57.600 lekë
IV. Fakulteti i Shkencave Sociale	72.000 lekë
V. Fakulteti i Mjekësisë	240.000 lekë
VI. Fakulteti Ekonomik	80.000 lekë
VII. Fakulteti i Drejtësisë	60.000 lekë
VIII. Fakulteti i Infermierisë	240.000 lekë
IX. Instituti i Studimeve Europiane	80.000 lekë
b) Universiteti Politeknik i Tiranës:	
I. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	72.000 lekë
II. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	72.000 lekë
III. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	45.000 lekë
IV. Fakulteti i Gjeologji Miniera	40.000 lekë
V. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	72.000 lekë
VI. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	40.000 lekë
c) Universiteti Bujqësor i Tiranës:	
I. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	43.200 lekë
II. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	48.000 lekë
III. Fakulteti i Shkencave Pyjore	43.200 lekë
IV. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	57.600 lekë
d) Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	48.000 lekë
e) Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	55.000 lekë
f) Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	55.000 lekë
g) Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër	48.000 lekë
k) Universiteti “F.S.Noli”, Korçë	48.000 lekë
l) Universiteti i Sporteve të Tiranës	95.000 lekë
m) Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan:	
i) Matematikë e zbatuar	48.000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	60.000 lekë
n) Qendra e Studimeve Albanologjike	100.000 lekë

**VENDIM**  
**Nr.94, datë 9.2.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME PËR MJEKIM, PËR VETE APO PËR FËMIJËT E PERSONAT NË KUJDESTARI, PËR PJESËN E PAMBULUAR NGA SIGURIMI I DETYRUESHËM SHËNDETËSOR, E PËR DEKLARATËN PERSONALE TË TË ARDHURAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13/3 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpenzimet vjetore që një tatimpagues bën për mjekim, për vete, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, që njihen si shpenzim i zbritshëm në bazë të shkronjës “c” të nenit 13/3 “Shpenzimet e zbritshme”, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, janë 8 532 (tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë.

2. Në rast të plotësimit të deklaratës nga kryefamiljari, bazuar në pikën 4 të nenit 13/1 të ligjit, shpenzimet vjetore për mjekim, për vete apo për fëmijët e personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, janë 8 532 (tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë për secilin anëtar të familjes, por jo më shumë se 32 000 (tridhjetë e dy mijë) lekë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për nxjerrjen e udhëzimit, në zbatim të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.5, datë 2.2.2011**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY-AL” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9, nenit 13, pika 1 germa “ç”, dhe nenit 45, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “f”, nenit 5, pika 1 germa “f”, neneve 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energy Supply-Al” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Supply-Al” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
  2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.6, datë 2.2.2011**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY-AL” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13, pika 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “g”, nenit 5, pika 1 germa “g”, neneve 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energy Supply-Al” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Supply-Al” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.7, datë 2.2.2011**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS AL” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, dhe neneve 13 e 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energy Partners Al” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Partners Al” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet: “Shkallë” me fuqi të instaluar 1.3 MW, “Cerrunje” me fuqi të instaluar 2.3 MW, “Plesha” me fuqi të instaluar 2.8 MW, “Bejni 1 dhe 2 Bejni” me fuqi të instaluar 3.6 MW, “Klos” me fuqi të instaluar 2.6 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.8, datë 2.2.2011**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS AL” SHPK NË AKTIVITETIN  
E TREGTIMIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13, pika 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “g”, nenit 5, pika 2 neneve 13 e 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Partners Al” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Partners Al” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.19, datë 21.1.2011**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR**  
**“TV SKAMPA”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV Skampa”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
  2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 13.4.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.20, datë 21.1.2011**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV**  
**KABLLOR LEZHA”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor kabllor “TV kabllor Lezha”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
  2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 12.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.21, datë 21.1.2011**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV ONUFRI”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor “TV Onufri”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
  2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.22, datë 21.1.2011**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR “RADIO +3”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio +3”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
  2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 23.9.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.23, datë 21.1.2011**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR**  
**“RADIO KLEA”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Klea”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
  2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.4.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.24, datë 21.1.2011**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR**  
**“TV PUKA”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV Puka”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
  2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.48, datë 21.1.2011**

**PËR REDUKTIMIN E KOHËS SË VLEFESHMËRISË SË LICENCËS SË TELEVISIONIT  
PRIVAT VENDOR “TELE 1”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Gent Ibrahim	anëtar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim sot në datë 28.7.2010 çështjen me:

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr.233, datë 21.12.2010 “Për reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tele 1”.

BAZA LIGJORE: neni 7 pika 21 dhe neni 137 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

**VËREN SE:**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.190, datë 22.10.2010, ka miratuar sanksionin e paralajmërimit ndaj subjektit televiziv privat vendor “Tele 1”, për arsye të mosrespektimit të strukturës programore për të cilën është licencuar.

Ky vendim i është njoftuar subjektit me shkresën nr.1530 prot., datë 2.11.2010. Sipas pikës 2 të këtij vendimi, subjekti kishte të drejtë të ankohej në gjykatë dhe deri më tani rezulton se subjekti nuk e ka ushtruar këtë të drejtë.

Në bazë të nenit 7, pika 2 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vijoi me monitorimin e programacionit të televizionit privat vendor “Tele 1”, si dhe me anën financiare të tij.

Pas periudhës së monitorimit, me vendimin nr.233, datë 21.12.2010, KKRT-ja vendosi paraprakisht reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tele 1” me 3 vjet (nga 5 vjet në 2 vjet). Sipas pikës 2 të këtij vendimi subjekti kishte të drejtë të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim brenda 30 ditëve.

Brenda afatit të mësipërm, në datë 7.1.2011 subjekti “Tele 1” ka depozituar kërkesën ankimore duke kërkuar revokimin e vendimit nr.233, datë 21.12.2010, ku ndër të tjera subjekti parashtron se:

“...për sa i përket strukturës programore, “Tele 1” i është drejtuar KKRT-së disa herë për të ndërhyrë ndaj shkeljeve që janë bërë ndaj të drejtave televizive nga operatorë të tjerë. Nuk është e vërtetë që kanë munguar edicionet e lajmeve, pasi “Tele 1” ka transmetuar vazhdimisht vetëm lajme. Lidhur me mosshlyerjen e detyrimit financiar për vitin 2010, nuk qëndron se për vitin 2010 janë paguar taksat, por nuk është paguar licenca, pasi institucioni juaj ka detyrimin për të bërë rakordimin e dy zërave-rimbursimin dhe mbifaturimin. Lidhur me ndërprerjen e transmetimit apo mungesës së sinjalit, asnjëherë nuk ka ndërprerë transmetimin në tejkallim të kufijve të përcaktuar në nenin 34. Ndërprerja është bërë për arsye të rinovimeve teknologjike. Vendimi për reduktimin e licencës është një vendim diskriminues, pasi ligji parashikon një seri gjobash dhe përsëritja e shkeljeve më shumë se 5 herë dënohet me uljen deri në 50% të afatit të licencës. Për sa më sipër, do t’ju luteshim të merrnit në konsideratë këtë ankim dhe përfundimisht të vendosni për pranimin e tij dhe revokimin e vendimit nr.233, datë 21.12.2010.”.

Lidhur me ankimin e mësipërm, sqarojmë si vijon:

Për sa u takon pretendimeve të ngritura nga subjekti televiziv privat vendor “Tele 1”, se i është përmbajtur strukturës programore për të cilën është licencuar, sqarojmë se:

Si argument kryesor për këtë çështje përmendet fakti se televizioni “Tele 1” i është drejtuar disa herë KKRT-së për të ndërhyrë ndaj shkeljeve që janë bërë mbi të drejtat televizive nga operatorë të tjerë, gjë që e ka detyruar këtë subjekt të bëjë ndryshime në strukturën programore të tij.

Që prej datës 28.5.2003, me shkresën me nr.315 prot., duke parë se “Tele 1” po vazhdonte transmetimin sipas një strukture të pamiruar nga KKRT-ja, kjo e fundit i ka kujtuar dhe tërhequr vëmendjen subjektit “Tele 1”, duke kërkuar të funksionojë sipas kërkesave të ligjit, pasi “Tele 1” nuk është licencuar si përsëritës televiziv, që transmeton 24 orë vetëm kanalet satelitore CNN dhe BBC Eorld.

Gjithashtu, me të njëjtën shkresë, i është theksuar televizionit “Tele 1” edhe fakti se nuk plotësohet kushti që të paktën 15% e programit javor, të përmbajë informacione dhe programe që lidhen me realitetin lokal. Sipas nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, subjekti është i detyruar të njoftojë KKRT-në për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur për marrjen e licencës, pra edhe për strukturën programore, por nuk mund t’i aplikojë këto ndryshime pa u miratuar nga KKRT-ja. Nga ankimesi përmendet shkresa e datës 18.8.2008 ku njoftohet KKRT-ja për reduktime të përkohshme në strukturën programore të “Tele 1”, deri në plotësimin e të drejtave programore, që në fakt kanë të bëjnë me ankesën për transmetim nga DigitAlb të BBC Eorld dhe CNN International.

Duke vlerësuar faktin se ritransmetimi i programeve nuk mund të jetë ekskluzivitet i asnjë televizioni, pasi licenca për operatorët analogë jepet për transmetime dhe jo ritransmetime programesh, KKRT-ja nuk e mori në konsideratë funksionimin e televizionit “Tele 1” nëpërmjet ritransmetimeve. Prandaj ky televizion nuk ka drejtë të ndryshojë strukturën programore pa pasur një vendim të KKRT-së.

Në lidhje me pretendimin tjetër, mbi përzgjedhjen nga ana jonë të periudhës së monitorimit, e cila për “Tele 1” nuk qenka e ndarë në mënyrë uniforme, theksojmë se dy periudhat e regjistrimit nga studioja e monitorimit të programeve të transmetuara nga televizioni “Tele 1”, janë në dy muaj të ndryshëm, shtator dhe nëntor, përkatësisht në datat 8.9.2010-12.9.2010 dhe 26.11.2010-30.11.2010.

Në vlerësim të kërkesës ankimore të shoqërisë tregtare “Teknotrade” sh.p.k., datë 7.1.2011 lidhur me pjesën e respektimit të strukturës programore, konstatojmë se:

- Dy periudhat kohore të monitorimit të përmendura më sipër, janë një tregues i qartë për të krijuar idenë e strukturës programore që ky subjekt televiziv aplikon.

- Informacioni i transmetuar nën siglën e “edicionit informativ”, përbëhet vetëm nga seanca plenare të Kuvendit të Shqipërisë dhe dy-tri kronika, të cilat përsëriten disa herë brenda ditës, duke mos pasqyruar asnjë informacion tjetër lidhur me problemet sociale dhe ekonomike të komunitetit e realitetit lokal.

- Duke iu referuar termit “edicion qendror lajmesh”, bëjmë me dije se ky përbën një term të njohur dhe pasqyruar në strukturën programore të licencuar të këtij subjekti.

- Mbështetur, gjithashtu, në vizionimin e programacionit të këtij subjekti, mungojnë programet argëtuese, zbavitëse, kulturore e artistike, të cilat së bashku do të përbënin një përqindje të konsiderueshme të kohës së transmetimit sipas strukturës programore të licencuar.

Nga ana tjetër, për sa i përket kërkesës ankimore ku pretendohet për “abuzivitet” nga ana e KKRT-së lidhur me shlyerjen e taksës për shërbimet radio-televizive”, sqarojmë si vijon:

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr.9975, datë 19.5.2008 “Për taksat kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, detyrimi për taksën për shërbime radio-televizive në vlerën 384 000 lekë, sipas faturës nr.44, datë 15.2.2010, duhej të shlyhej brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Në fakt, likuidimi i sipërpërmendur është kryer në datën 10.1.2011, ndërkohë që vendimi për reduktimin e licencës është marrë në datë 21.12.2010. Për sa më sipër, mendojmë se shkelja nga ana e subjektit është evidente dhe pretendimet tuaja janë të pabazuara.



Për sa i përket rimbursimit të shpenzimeve për ndryshimin e frekuencës të kërkuara me letër tuaj, datë 31.12.2008, nuk është vepruar, pasi për kryerjen e çdo shpenzimi të paraqitur në letër duhet të bashkëlidhen dhe dokumentet justifikuese, si fletë dalje ose faturë.

Së treti, referuar ankesës së “Tele 1” lidhur me ndërprerjen e transmetimit apo të mungesës së sinjalit, sipas së cilës asnjëherë nuk ka ndërprerë transmetimin në tejkalim të kufijve të përcaktuar në nenin 34, si dhe ndërprerja është bërë për arsye të rinovimeve teknologjike, sqarojmë si më poshtë vijon:

Lidhur me ankesën e subjektit “Tele 1” për njoftimin e interferencave nga subjekte të tjera, nga referencat e dhëna mbi korrespondencën (“Njoftim për ndërhyrje në sinjalin e “Tele 1”, datë 25.3.2003 dhe “Njoftim për ndërhyrje të sinjalit të TVSH-së në sinjalin e “Tele 1”, datë 24.6.2003”), rezulton se problemet kanë ndodhur në një periudhë të mëparshme licencimi dhe nuk kanë të bëjnë me gjendjen aktuale, aq më tepër po të kujtojmë se “Tele 1” në atë periudhë transmetonte në ch 21 UHF, ndërsa aktualisht, ai transmeton në ch 68 UHF. Subjekti është rilicencuar nga KKRT-ja me gjendje teknike brenda normave.

TV “Tele 1” është licencuar për të mbuluar me sinjal televiziv analog zonën ku përfshihen 4 qarqe: Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier. Në bazë të kësaj licence subjektit i është rezervuar e drejta të japë shërbim në këtë hapësirë dhe në bazë të këtij rezervimi, mbështetur në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998, i është llogaritur edhe pagesa përkatëse për licencë. Nga subjekti nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për zvogëlimin e zonës së licencimit, as për vendosjen e transmetuesëve në pika të tjera, përveç atyre ekzistuese.

Për sa i takon pretendimit të subjektit në lidhje me arsyet e mosdaljes në transmetim nga ana e televizionit “Tele 1”, KKRT-ja ka filluar procedimin administrativ me një tjetër hetim administrativ, i cili po shqyrtohet më vete, ndaj Këshilli vendosi ta veçojë këtë pjesë të këtij procedimi.

Së fundi, me anë të ankesës së paraqitur “Tele 1” pretendon se sipas nenit 137/4 përsëritja e shkeljeve më shumë se 5 herë dënohet me uljen deri në 50% të afatit të licencës, dhe “Tele 1” nuk ka asnjë sanksion me gjobë.

Pretendimi i mësipërm nuk qëndron, sepse në bazë të nenit 137 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, KKRT-ja në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji mund të vendosë një prej sanksioneve si më poshtë vijon:

1. Paralajmërim;
2. Gjobë deri në 3 për qind të xhiros vjetore të të ardhurave;
3. Pezullim i përkohshëm i licencës;
4. Reduktim i kohës së licencës;
5. Heqje e licencës.

KKRT-ja përcakton shkeljet konkrete, të cilat ndëshkohen nga sanksionet e përcaktuara në këtë nen, duke zbatuar fillimisht si rregull sanksionin e paralajmërimit. Ndaj televizionit “Tele 1” është vendosur fillimisht sanksioni i paralajmërimit dhe më pas është marrë vendimi paraprak për reduktimin e licencës.

Për sa i takon pretendimit të subjektit në lidhje me ndryshimet në pronësinë e subjektit të licencuar, ato, gjithashtu, janë objekt i një procedure tjetër të KKRT-së dhe do të shqyrtohen në atë procedurë.

Për gjithë sa më sipër, si dhe duke marrë në konsideratë edhe faktin që subjekti pavarësisht se jashtë afatit ligjor ka shlyer detyrimin për pagesën e taksës për shërbime radio-televizive, KKRT-ja ka vendosur të pranojë pjesërisht ankimin.

Për këto arsye,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bazë të nenit 7, pika 21 dhe nenit 137 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 29 të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, vendimit nr.233, datë 21.12.2010, si dhe pasi dëgjoi përfaqësuesin e subjektit,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të ankimit. Reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës së televizionit privat vendor “Tele 1” në masën 50% të afatit të saj (nga 5 vjet në 2 vjet e gjysmë, pra afati i licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tele 1” mbaron në datën 3.7.2011).

2. Kundër këtij vendimi subjekti mund të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”, duke filluar ky afat nga momenti i marrjes në dijeni.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2011 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 17.2.2011

Doli nga shtypi më 18.2.2011

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 36 lekë